



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 1

Tiranë – E mërkurë, 13 janar 2016

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 11.1.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ALBSReP)”, të ndryshuar... 3
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 11.1.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e lëshimit të dokumenteve nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 43, datë 6.1.2016	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Leje ndërtimi për rikualifikimin urban të sheshit “Avni Rustemi” dhe “Pazarit të Ri””... 3



## VENDIM

Nr. 12, datë 11.1.2016

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 375, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, REGJISTRIMIN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, TË ADMINISTRIMIT E TË NDËRVEPRIMIT DHE PËR SIGURINË E SISTEMIT TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME (ALBSReP)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

Në fund të nënndarjes “i”, të shkronjës “ç”, të pikës 6, të vendimit nr. 375, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen fjalët “... dhe e drejta për të aplikuar *on-line* për shërbimet e miratuara me marrëveshje mes Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## VENDIM

Nr. 13, datë 11.1.2016

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 376, DATË 6.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURËN E LËSHIMIT TË DOKUMENTEVE NGA ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të paragrafit të fundit, të nenit 23, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 376, datë 6.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ofron shërbimin *on-line* për kërkesat për aplikim për kryerjen e shërbimeve për noterët. Shërbimet përkatëse të ofruara *on-line* për noterët miratohen me marrëveshje të përbashkët mes Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të funksionojë një regjistër i veçantë elektronik i kërkesave për aplikim *on-line* dhe një regjistër tjetër për përpunim të kërkesave për aplikim dhe i lëshimit të dokumenteve nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.”.

3. Në pikat 4, 5 dhe 6, termi “Regjistri elektronik” zëvendësohet me “Regjistrat elektronik”.

4. Pas pikës 17 shtohet pika 17/1, me këtë përmbajtje:

“17/1. Procedurat dhe mënyra e trajtimit të kërkesave, sipas pikës 3/1, përcaktohet me një udhëzim të përbashkët të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve.”.

II. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

## KËRKESË

Nr. 43, datë 6.1.2016

## PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Leje ndërtimi për rikualifikimin urban të sheshit “Avni Rustemi” dhe “Pazarit të Ri””.



Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët, do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 76,474,427 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I ZHVILLIMIT  
URBAN  
Gjon Radovani



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga projekti për Rehabilitimin Urban të sheshit Avni Rrustemi dhe Pazarit të Ri.

Nr	EMER MBIEMER	Zona Kad.	NR. Pas.	SIP. Përgj. Truall	SIP. Prekur Truall	Çmimi për Truall.	Objekti sip. Përgjith.	Objekti sipfaqja preket.	Çmimi për Objekt.	VLERA për tr. + obj. në	KONFIRM.ZVRPP, TIRANE	SHENIME
1	Shtet (Truall+Objekt)	8150	2/450	962	962	57126.00	962.00	0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
2	Shtet (Rrugë)	8150	2/91	2469	2469	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
3	Pronar i pa vërtetuar	8150	2/289	29.8	29.8	57126.00		0.00	0.00	1702354.80	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
4	Bashkpr. Mulleti, Dino, Saraçi,Estalaku.	8150	2/106	671.8	671.8	57126.00	0.00	0.00	0.00	38377246.80	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	urdher kufizimi
5	Bajram Ali Ismailaj	8150	2/101	14.2	14.2	57126.00		0.00	0.00	811189.20	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
6	Shtet (Shesh)	8150	2/100	142.3	142.3	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
7	Shtet (Truall+Objekt)	8150	2/98	269	269	57126.00	266.00	266.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
8	Shtet (Truall+Objekt)	8150	2/96	173	173	57126.00	43.00	43.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
9	Gëzim Kallmeti	8150	2/94	30	30	57126.00	30.00	30.00	28568.00	2570820.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
10	Luan Saliko Tomani	8150	2/332	6	6	57126.00	6.00	6.00	22649.00	478650.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
11	Latif Tajar Dobi	8150	2/333	16	16	57126.00	6.00	6.00	22649.00	1049910.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
12	Eduart Hysen Bardhi	8150	2/451	70	70	57126.00	49.30	49.30	38491.00	5896426.30	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
13	Shtet (Rrugë)	8150	5/442	3618.7	100	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
14	Shtet (Rrugë)	8150	5/2	669.9	200	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
15	Shtet ka qen konf.6/239, rruge	8150	6/490	4718.11	4718.11	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/3,prot.dt.12.10.2015	
16	Shtet (Rrugë)	8150	6/94	1038	61	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/3,prot.dt.12.10.2015	
17	Shtet (Shesh)	8150	6/410	627.7	627.7	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
18	Shtet (Rrugë)	8150	6/407	3614.1	358	57126.00		0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	
19	Bashkpr. Mineri, Vorpsi, Ylli, Zyrbo, Shehaj, Sheqeri, Juma, Boku, Bardhi.	8150	6/80	731	59	57126.00	210.00	0.00	0.00	3370434.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	



20	Shtet (Truall)	8150	2/428	170	170	57126.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015		
21	Shtet (Shesh)	8150	2/471	299	70	57126.00	0.00	0.00	0.00	0.00	Konf.shkr.nr.29112/3,prot.dt.12.10.2015		
22	Bashkpr.banoreve te pall.	8150	2/105	276.7	276.7	57126.00	276.7	276.7	12494.00	19263854.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	rikerk. konfirmim	4 pjese, tab.poshte
23	Refat Duro	8150	2/535	0	0	57126.00	22.00	22.00	15091.00	332002.00	Konf.shkr.nr.29112/3,prot.dt.12.10.2015		
24	Gani Duro	8150	2/536	0	0	57126.00	23.00	23.00	15091.00	347093.00	Konf.shkr.nr.29112/3,prot.dt.12.10.2015	kufizimi tr.	2/106
25	Qanije Kamberi	8150	2/537	0	0	57126.00	17.00	17.00	15091.00	256547.00	Konf.shkr.nr.29112/3,prot.dt.12.10.2015	urdher kufizimi tr. uroner	2/106
26	Arjan Ali Hidri	8150	2/451	25	25	57126.00	25.00	25.00	23590.00	2017900.00	Konf.shkr.nr.29112/1,prot.dt.03.09.2015	kufizimi tr.	2/106
				Shuma	11518.61	m <sup>2</sup>		764.00	m <sup>2</sup>	76474427.10	lekë		

**SHËNIM:**

- Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 514, dt.30.07.2014.
- Pasuritë e prekura nga projekti, Konfirmohen nga ZVRPP, Tiranë, me shkresat nr.prot. 29112/1, dt.03.09.2015 dhe nr.prot. 29112/3, dt.03.09.2015.
- Për pas.nr.2/105 pranë Bashkisë Tiranë janë depozituar dokumenta për ndarjen e saj në kater pasuri 2/105-N1, 2/105-N2, 2/105-N3, 2/105-N4, për të cilat jemi në pritje të konfirmimit nga ZVRPP, Tiranë.
- Bashkëlidhur do të gjeni llogaritjet për çmimin njësi (m<sup>2</sup>) për secilën ndërtesë.
- Pasuria nr.2/401 është menaxhuar në leje ndërtimi të dhënë nga Bashkia Tiranë dhe prandaj nuk është në tabelën e llogaritjeve paraprake.

Dt. 21.12.2015

Ing. Topogjeodete Sh.CIV/CI

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2016

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 56 lekë